



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1485 prot.

Fushë-Arrëz, më 02. 06. 2025

Procesverbal

I mbajtur sot, më 02.06.2025, ditën e hënë, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, mbi mosrealizimin e konsultimit publik për shpërndajen e transfertës së pakushtëzuar të trashëguar, transfertës specifike të trashëguara dhe të ardhurave nga viti 2024 që do të përdoren gjatë vitit 2025.

Në konsultim u paraqitën: Kryetari i Bashkisë, Zv.kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit, Kryetari i Komisionit të Ekonomisë Financë Buxhetit dhe Mbikqyrjes Financiare Planifikimit Strategjik, Drejtori i Shërbimeve Publike, Përgjegjësi i Zyrës së Financës, Përgjegjësjë për Burimet Njerëzore, Përgjegjësi i Zyrës së Emergjencave Civile, Sekretarja e Këshillit, Kryetari i Fshatit Fushë-Arrëz dhe Punonjësjë e sekretariatit të Këshillit Bashkiak.

Megjithëse njoftimi është bërë në kohë dhe është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në anbjentet e brendshme dhe të jashtme të Bashkisë, për arsye të numrit të vogël të pjesëmarrësve, ishte e pamundur të zhvillohej kjo konsultë publike organizuar nga Këshilli Bashkiak.

Pas një pritje prej rreth një ore, Kryetari i Komisionit vendosi që ky konsultim të anulohet! Kryetari i Komisionit iu rekomandoi Drejtuesve të Bashkisë, që me paraqitjen e këtij projekti, në mungesë të realizimit të konsultimit të planifikuar, të mbajnë në konsideratë rekomandimet e dala gjatë konsultimeve të zhvilluara për buxhetin e vitit 2025 në muajin Tetor- Dhjetor 2024.

SEKRETAR

Naze SELIMI

